

VENDIM
Nr. 1096, datë 24.12.2020

**PËR MIRATIMIN E BUXHETIT PËR AUTORITETIN E KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE, PËR VITIN 2021**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 117, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fondit të shpenzimeve të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), për vitin 2021, për shumën 392 000 000 (treqind e nëntëdhjetë e dy milionë) lekë, sipas pasqyrës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Pasqyra nr. 1

**PLANI I SHPENZIMEVE TË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE
DHE POSTARE, PËR VITIN 2021**

Të ardhura	Në mijë lekë	Shpenzime	Në mijë lekë
Të ardhura nga pagesa për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike	170,000	Shpenzime për paga dhe shtesa të tjera	109,800
Të ardhura nga pagesa për caktimin dhe përdorimin e frekuencave	132,000	Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësor e	15,000
Të ardhura nga pagesa për numeracionin	26,000	Shpenzime për materiale	8,850
Të ardhura nga pagesa për koston e shërbimit të portabilitetit të numrit	20,160	Shpenzime për shërbime	150,967
Të ardhura nga mbikëqyrja e tregut të shërbimit postar	9,000	Shpenzime për investime	107,382
Të ardhura nga pagesa për <i>domain</i>	9,500		
Të ardhura nga pagesa dhe të ardhura të tjera	340		
Të ardhura nga Komisioni, nga agjenti tatimor	25,000		
Totali i të ardhurave	392,000	Totali i shpenzimeve	392,000